



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	08.08.2024 21.08.2024
NR/BR.	258/24
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës së Ferizajt
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim –Vendim për këmbimin e pjesës së ngastres kadastrale; 3621-14 Z.K Jezerc, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 3485-4 Z.K. Jezerc, pronë e komunës së Ferizajt

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15 qershor 2008), nenit 24 të Ligjit nr.06/L- 092, për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës 7 Mars 2019, neni 29 pika 1, Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te dates 28.06.2013. Kryetarit i Komunës përmes Komitetit për Politik dhe Financa i propozon Kuvendit të Komunës të miratojë:

Vendim

Për;

- Këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale;
 - 3621-14 Z.K. Jezerc me sipërfaqe prej 518 m², pronë e Hajrush (Milaim) Beqiri
 - Pjesen e ngastres kadastrale 3485-4 Z.K. Jezerc me sipërfaqe prej 334 m², pronë e komunës së Ferizajt.

2. Pronat të cilat propozohen të këmbehen janë të regjistruara parcela 3621-14 Z.K. Jezerc në pronësi të Hajrush (Milaim) Beqiri me sipërfaqe prej 518 m² Zk. kurse parcela 3485-4 Zk Jezerc është në pronësi të komunës me sipërfaqe prej 334 m². Në këto parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.
3. Pronat e përshkruara më lartë këmbehen për interes të përgjithshëm publik asfaltimin e rrugës "Selman Uka" ne fshatin Jezerc.
4. Pronat të cilat propozohen të këmbehen janë shpallur interes i përgjithshëm sipas vendimit të kuvendit komunal me nr. 01. Nr. 09, datë 31.01.2024, në bazë të të cilit vendim edhe është bërë vlerësimi i pronave nga Ministria e Fianancave – Departamenti i Tatimit në Pronë, parcela kadastrale 3485-4 Z.K. Jezerc, pronë e komunës është vlerësuar 25,00 € për m², prona private-parcela kadastrale 3621-14 Zk. Jezerc është vlerësuar 25.00 € për m², andaj në bazë të vlerësimit këmbimi paluejtshmëive do të bëhet ashtu siç është përcaktu në nenin 1 të këtij vendimi. Për çfardo vlerësimi shtesë pala nuk kërkon kompensim sipas deklaratës me numer 10.Nr. 463-215 te dates 19.08.2024,
5. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara më lartë do të evidentohen ne librat kadastral. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra komunale kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

Të bashkangjitura në këtë propozim vendim i gjeni;

- *Vendimin e Kuvendit me nr. 01. Nr.09, datë 31.01.2024,*
- *Certifikatat e pronësisë*
- *Raportin e vlerësimit të pronave.*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/ VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministartvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme
Odeljenje za Procenu Nepokretnosti - Immovable Property Appraisal Department

Komuna: Ferizaj Zona Kadastrale: Jezerc

Odeljenje za Procenu Nepokretnosti – Immovable Property Appraisal Department							
Komuna: Ferizaj Zona Kadastrale: Jezerc							
Të dhënat sipas Elaboratit /Certifikatës së Pronës							
Pronar/Posedues		Numri i pronës	Lloji i shfrytëzimit të pronës/klasa e kualitetit	Sipërfaqja e Përgjithshme m ²	Sipërfaqja për vlerësim m ²	Çmimi i tokës (€ /m ²)	Totali (€)
Nr.							
1	Hajrush (Milaim) Beqiri	3621-14	Mal 2	518	518	25.00	12,950.00



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlaze: Date / Dana: 01.02.2024		
Nr. Org. Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 09	Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac		

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 09
Data: 31.01. 2024

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139 me ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit numër 03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës 7 Mars 2019, dhe nenin 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës Ferizajt 01.nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2024 miratoi këtë:

VENDIM
PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM TË PJESËS SË
NGASTRËS KADASTRALE: 3621-14 Z.K.JEZERC, PRONË PRIVATE, ME QËLLIM
TË KËMBIMIT ME PJESËN E NGASTRËS KADASTRALE 3485-4 Z.K.JEZERC,
PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT.

I
Shpallet interes i përgjithshëm-publik pjesa e ngastrës kadastrale 3621-14 Z.K.Jezerc, me sipërfaqe 518m², pronë private e Hajrush (Milaim) Beqiri.

II
Parcela e lartëcekur në nenin i të këtij vendimi shpallet interes i përgjithshëm me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës 3485-4 Z.K.Jezerc, pronë e Komunës së Ferizajt.

III
Pronat e përshkruara më lartë këmbehen për interes të përgjithshëm publik, me rastin e asfaltimit të rrugës "Selman Uka" në fshatin Jezerc parcela kadastrale i është marrë nga Komuna e Ferizajt, andaj personi Fizik ka kërkuar nga Komuna që të bëhet rregullimi i parcelave respektivisht këmbimi i tyre, pavarësisht se mund të ketë dallime në sipërfaqe, personi fizik nuk kërkon kompensim shtesë, në këto prona nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

IV

Këto prona këmbehen pas vlerësimit nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë dhe këmbimi i paluejtshmërive do të bëhet në proporcion me vlerat e tyre, në përputhje me vlerësimin e bërë nga Ministria e Financave- Departamenti i Tatimit në Pronë. Pra ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njehti shërben vetëm për vlerësimin e palujtshmërive.

V

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Gjeodezisë dhe Kadastrit.

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Zharit Zariqi



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Besim Myrtezani, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë e aktit të komunës së Ferizajt
Lloji i aktit:	Vendimit

Datë: 09/02/

2024

Nr. 020-101

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullore (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim paraprak Nr. 09 për shpalljen e interesit të përgjithshëm në ngastrën kadastrale 3621-14 Z. K Jezerc

I miratuar më datë: 31.01.2024

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.02.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2024, ka miratuar Vendim paraprak Nr. 09 për shpalljen e interesit të përgjithshëm në ngastrën kadastrale 3621-14 Z. K Jezerc.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt është i bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale neni 12 dhe Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës neni 6 dhe 8.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Ferizajt me datë 31.01.2024, me 27 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim. Vendim paraprak Nr. 09 për shpalljen e interesit të përgjithshëm në ngastrën kadastrale 3621-14 Z. K Jezerc bëhet me qëllim të "Këmbimit me pronën e komunës për realizimin e projekti asfaltimi i rrugës "Selman Uka" në fshatin Jezerc".

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



DREJTORIA PËR , PRONË, GJEODEZI DHE KADASTER
UPRAVA ZA IMOVINU, GEODEZIJU I KADASTAR
DEPARTMENT OF ,PROPERTY , GEDESY & CADASTAR

DATA/DATUM/DATE	19.08.2024
NR/BR.	10-Nr463-215

PËR/ZA/TO	1.Drejtorin 2.Hajrush Beqirin
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Drejtorisë për Pronë,Gjeodezi dhe Kadastër
NGA/OD/FROM	Spektori i Pronës
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Deklaratë

Përpiluar me datë **19.08.2024** në Drejtorin e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit lidhur me kërkesen me kembimin e ngastrave kadastrale 3621-14 dhe 3485-4 Zk. Jezerc.

Në Drejtorin e Pronës. Gjeodezisë dhe Kadastrit ka prezentuar: Hajrush Beqiri i lindur më 05.04.1969 në fshatin Radivojc me vendbanim në Ferizaj Rr. "Gjon Serreçi" me nr personal të letërnjoftimit 1012463428 i identifikuar me numer të ID 1777433 leshuar nga MPB-ja e RKS-së, shqiptar, shtetas ei RKS-së i cili vullnetarisht në prezencën e Udhëheqësit të Sektorit të Pronës Bekim Idrizi e jep këtë:

DEKLARATË

Unë pronari i paluajtshmërisë i ngastres kadastrale:3621-14 Zk. Jezerc deklaroj para Organit të Administrates Komunale se me përgjegjësi më të lartë morale, penale dhe materiale jam pronar i parces ashtu siç dokumentohet edhe në çertifikaten e pronësisë.

Parcela e cila është e mija prona private ngastra kadastrale 3621-14 Zk. Jezerc e cila është këmbyer me pronen komunale me numer 3485-4 Zk. Jezerc sipas vendimit të KK Ferizaj me numer 01.Nr.09 të datës 31.01.2024 dhe janë vlerësuar nga Ministria e Financave ,Punes dhe Transfereve me një diferenc prej 4600 € me shumë se prona komunale unë nuk kërkoj kurfarë kompensimi shtesë nga KK Ferizaj për këtë ngastër kadastrale.

Kërkoj nga Drejtoria që sa më parë të jetë e mundur që të përbyllet çështja e kembimit të këtyre paluajtshmerive konform legjislacionit në fuqi Vendimit të KK Ferizajit dhe Ligjit për Dhënjën në Shfytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Ligji 06/L-092 të Republikës së Kosovës.

Tjetër skam çka të shtoj deklaratën e pranoj dhe e nënshkruaj pa kurfar vërejtje

Pala
Hajrush Beqiri

Udhëheqesi i Sektorit
Bekim Idrizi jur. i dëp



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE
Zgjidhje

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72217044-03621-14

Nr. referencës / Broj Predmet / Case Referent Number: 71162-2024
Data e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 19.08.2024 - 11:38
Opština / Municipality: FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ
Zona / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Jezerc / Jezerce / Liqeni
Kancelaria / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ

HEËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Lloji i njësiesë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna Imovina / Privately owned Land	Rural	518	RPP.72/2023	28.07.2023	

ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
LAMA			28.07.2023	

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²) (m²) (m²)
1	Pyjor/šumsko/Forestry	Tokat Pyjore/šumsko zemljište/Forest	Mal I Klasës 6/Suma 6 Klase/6th Class Forest	518

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postai Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosći adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posëdim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	BEQIRI HARUSH (MILAIM)	1012463428	FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ /		MARUE SHLLAKU	1/1	203/2023	23.08.2023





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

27th of June

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72217044-03485-4

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 71162-2024
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 19.08.2024 - 11:38
Komuna / Opština / Municipality: FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Jezerc / Jezerce / Ligeni
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-72217044-03485-4	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shogëitore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	6515	RFP.107/2023	24.10.2023	24.10.2023

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS


Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ZA UGZMALJ MAHALU			24.10.2023	24.10.2023

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vista koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure	Rrugë E Kategorizuar/Nekategorisani Put/UncategorizedRoad		6515

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosći adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Ferizajt	600629804	/ / /		DËSHMORET E KOMBIT	1/1		25.10.2023



ME kete situacion kemi paraqit ng.3621-14 ng me sip 518m2 pron me te me projekt e kan asfaltu per infrastruktur

ME pjesen e ng. 3584-4 pron komunale rrug

FERIZAJ ME 19.01.2024

PUNOI: ISMAIL KAMBERI

[Handwritten signature]



ME kete situacion kemi paraqit ng.3621-14 ng me sip 518m2 pron me te
me projekt e kan asfaltu per infrastruktur
ME pjesen e ng. 3584-4 pron komunale rrug

FERIZAJ ME 19.01.2024

PUNOI: ISMAIL KAMBERI